



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
MINISTRI

Nr. 5326/1 prot.

Tiranë, më 19. 5.2025

URDHËR

Nr. 74, datë 19. 5.2025

“PËR

**SHPLLJEN E PËRKTHIMIT TË STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË
RAPORTIMIT FINANCIAR 18 “PARAQITJA DHE DHËNIA E
INFORMACIONEVE SHPJEGUESE NË PASQYRAT FINANCIARE” (SNRF
18) DHE STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR
19 “FILIALET PA PËRGJEGJËSI PUBLIKE: DHËNIA E INFORMACIONEVE
SHPJEGUESE” (SNRF 19)”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e përkthimit të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 18 “Paraqitja dhe dhënia e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare” (SNRF 18) dhe Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 19 “Filialet pa përgjegjësi publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese” (SNRF 19).
2. Aplikimi i SNRF 18 “Paraqitja dhe dhënia e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare”, të publikuar në Prill 2024 dhe SNRF 19 “Filialet pa përgjegjësi publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese” publikuar në Maj 2024, ka datë efektive më 1 Janar 2027, por lejohet zbatimi më i hershëm i tyre.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

MINISTRI

